# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-473709**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Fluks në shërbimin neuropsikiatrik në Shkodër, faktorët socialë, ekonomikë dhe stresi ndër shtytësit krye sorë |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/sociale/fluks-ne-sherbimin-neuropsikiatrik-ne-shkoder-faktoret-sociale-ekonomike-i588721` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 12:20:47 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 12:50:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `ab2813b3909df45b91c30738eb0f9cef8b06d99cbb91952cfc5f6b244045c44f` |
| TEKSTI | `23b34b1f2b9d751976d2f6d29cc4e7291490102ec303e23dfa1400fc904dccb5` |
| PAMJA | `201365e98aa7db9030d7288fc2d9faa1d978d783381ca605515b9e81f08a18ec` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `fde341d3689f3e1e598b6c6ababbd289cf96dd6903c226d70dac813ffb7f7f3b` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `7677d8d9488aa5a9422459265187ef4d7802fbf31e13dbd8fed410ad19a65ead` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/fde341d3689f3e1e598b6c6ababbd289cf96dd6903c226d70dac813ffb7f7f3b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Fluks në shërbimin neuropsikiatrik në Shkodër, faktorët socialë, ekonomikë dhe stresi ndër shtytësit kryesorë

TemA

27 Shtator 2026, 14:50Sociale TEMA




Shërbimi i Neuropsikiatrisë në Poliklinikën e Specialiteteve në Shkodër po përballet me një fluks në rritje të pacientëve që kërkojnë ndihmë mjekësore. Të dhënat zyrtare flasin për dhjetra vizita ditore pranë këtij shërbimi. Përveç konsulencave ditore, mjekët specialistë thonë se në rritje janë edhe rastet urgjente si dhe shtrimet spitalore.

*"Mesatarisht, këtu marrin shërbime të natyrave nga më të ndryshme mbi 30 pacientë. Ne hasim përditë raste ku në urgjencë paraqiten të sëmurë, edhe sëmundje që kanë një rritje të krizave, rritje të rasteve që paraqiten në urgjencë, rritje të nevojës për shtrimin në spital"*, tha Mark Preçi, mjek neuropsikiatër.

Simptomat e pacientët janë nga më të ndryshmet, por në pjesën më të madhe të rasteve mbizotërojnë çrregullimet e ankthit, gjendjet depresive dhe stresi i grumbulluar. Faktorë sociale, ekonomike, si dhe stresi vlerësohen si shtytësit kryesorë që po çojnë në përkeqësimin e shëndetit mendor te grupmoshave të ndryshme.

*"Sëmundje kronike, si skizofrenia, depresioni, çrregullimet bipolare apo çrregullimet e ankthit, janë shumë të shpeshta. Por edhe fëmijët kanë problemet e tyre të moshës, por që ata janë ndoshta, mund të them, një kontingjent që janë më shumë nën kujdesin e prindërve apo të kujdestarëve të tyre dhe janë më pak të ndjeshëm nga këto fenomene. Të rriturit dhe të moshuarit janë shumë më të ndjeshëm për shkak të pavarësisë që kanë në lëvizje apo në aksesin që kanë në shërbime, e të tjera, e të tjera"*, tha ai.

Specialistët bëjnë thirrje që qytetarët të mos i neglizhojnë simptomat e para të stresit apo ankthit dhe të kërkojnë ndihmë profesionale pa hezituar, për të parandaluar rëndimin e gjendjes shëndetësore. /rtsh

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Fusha sportive, pista vrapimi e kënde lojërash, Rama prezanton parkun e ri në Elbasan]

12:00 Sociale / 6 komente

Zhvillohet sot "Tiranathlon"/ Ja rrugët ku kufizohet qarkullimi dhe linjat urbane që do të devijojnë

08:50 Sociale

[Fiksoi në fotografi eksodin e shqiptarëve në Bari, ndahet nga jeta fotoreporteri legjendar italian]

08:05 Sociale / 3 komente

[Fluks udhëtarësh nga Kosova në Shqipëri: Nga 30 shtatori rikthehen kontrollet kufitare]

22:15 Sociale / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.